



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

01Nr. 60//01-1863/22
Kaçanik, 25.01.2022

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e **I-r (Parë)** e Rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa (Legjislatura e VII e Kuvendit të Komunës), mbajtur me 25 Janar 2022. Për shkak të kushteve teknike, mbledhja u mbajt në katin e dytë të objektit të administratës komunale, në Zyrën e kryetarit të komunës, me fillim pune në ora 11:00.

Pjesëmarrës në mbledhje nga Komiteti për Politikë dhe Financa- KPF, ishin të gjithë anëtarët dhe atë:

1. Kemal Murseli	PDK	Kryesues sipas funksionit
2. Kadri Krivenjeva	PDK	anëtar
3. Fitore Vishi	PDK	anëtar
4. Agim Mani	LVV	anëtar
5. Kadrije Lika-Troni	LVV	anëtar
6. Ardita Rrahmani	LDK	anëtar
7. Rabije Sallahi	AAK	anëtar.

Nga Ekzekutivi i Komunës në mbledhje morën pjesë; Kryetari i Komunës, Besim Ilazi, Nënkryetari i komunës, Sabedin Vishi, ndërkaq nga zyrtarët ishte Fatlume Selimi.

Mbledhjen e kryesoj, Kemal Mërseli, Kryesues i Kuvendit.
Procesmbajtës: Makfir Malsiu, Zyrtarë për punë të KK.

Fillimisht Kryesuesi i Kuvendit, Kemal Mërseli, i përshëndeti pjesëmarrësit e kësaj mbledhje, pasi është mbledhja e parë e këtij komiteti, po ju flas pak për rolin dhe rëndësinë që ka ky komitet. Sipas Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (LVL) janë 2 komitete obliguese të cilat duhet t'i formoj Kuvendi i Komunës: 1. Komiteti për Politikë dhe Financa dhe 2. Komiteti për Komunitete. KPF gjithnjë i paraprinë mbledhjeve të KK, në njëfarë forme është një kryesi e KK. Temat të cilat trajtohen në KK, paraprakisht trajtohen në KPF. Organi vendimmarrës është KK, por pasi që është ngarkuar me kompetenca KPF i trajton çështjet të cilat i adresohen dhe të njëjtat ia rekomandon KK ashtu si janë propozuar apo me ndonjë ndryshim. Kjo është mbledhja e parë e KPF e kësaj legjislature, kuorum ekziston, kushte pune me u mbajtur mbledhja ka, andaj e hapi mbledhjen e I-r të Rregullt të KPF-a për vitin 2022, data 25 Janar 2022, me këtë:

REND PUNE

1. Plani i punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2022;
2. Plani i punës së Ekzekutivit të Komunës për vitin 2022;
3. Raporti i punës së Komitetit Konsultativ për Personat me Aftësi të Kufizuara, për vitin 2021;
4. Propozim Vendimi për formimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi-KKSB;

5. Informatë e drejtorisë së Arsimit për përfundimin e periudhës të parë të Vitit shkollor, 2021/2022;
6. Propozim Vendimi për ndarjen e masës drusore të konfiskuar në vitin 2021, shkollave të komunës;
7. Kërkesa e Asociacionit të Komunave të Kosovës- AKK, për emërimin e delegatëve në Kuvendin e AKK.

Kryesuesi i kuvendit: lidhur me rendin e propozuar të punës e hapi diskutimi: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë rendin e punës e shtroj në votim për aprovim dhe njëjti u aprovua njëzëri. Në sajë të kësaj del konstatimi së KPF e

Aprovoj

Rendin e punës në përbërje prej 7 pikëve.

U kalua në shqyrtimin e pikave sipas rendit të punës;

2. Plani i punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2022;

Kryesuesi i Kuvendit: Siç e dini edhe ju, në mbledhjen e fundit të KK është formuar një komision për hartimin e planit të punës së KK. Plani është hartuar nga zyrtarja për punë të KK në bashkëpunim me komisionin, të cilët i falënderojmë për këtë punë. Komisioni është mbledhur në një takim punë dhe e kanë nxjerrë draft- plan të punës së KK. Unë nuk kam qenë në atë takim për shkak të disa angazhimeve tjera. Në vitin 2022 sipas LVL KK është i obliguar t'i mbajë 10 mbledhje të rregullta. Minimumi i mbledhjeve me pagesë është 10, maksimumi i mbledhjeve me pagesë është 12. Mbledhjet do të mbahen në fund të muajit, me përjashtim në muajin korrik do të mbahen 2 mbledhje për shkak së me plotësuar muaji gusht, që është planifikuar muaj i pushimeve. Në plan janë paraparë kompensimet për paga dhe mëditje me buxhetin e planifikuar dhe planifikimet nga mallrat e shërbimet, ku pos tjerash është planifikuar edhe një vizitë zyrtare, e cila është realizuar edhe në vitet tjera. Plani është në vija të trasha, i njëjti mund të plotësohet dhe ndryshohet sipas kërkesave dhe nevojave të cilat paraqiten. Çdo çështje që i adresohet KK, paraprakisht shqyrtohet në KPF. Komisioni i KK planin i ka përcjellë në procedurë të KPF dhe KK. Materialin e keni marrë, nëse ka kush diçka e hapi diskutimin:

z. Agim Mani: Unë e kam lexuar planin e punës së KK. Plani shihet së është i harmonizuar mirë, ndërkaq nëse del ndonjë çështje e jashtëzakonshme, besoj së do shqyrtohet në KK edhe pa qenë i përfshirë në plan.

znj. Ardita Rrahmani: Faleminderit kryesues, ne paraprakisht jemi konsultuar me subjektin tonë politik- LDK, dhe jemi pajtuar me këtë plan pune.

Kryesuesi i Kuvendit, Diskutime të tjera nuk ka, atëherë planin e punës së KK për vitin 2022 me ia adresuar KK e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në sajë të kësaj konstatohet së, Komiteti për Politikë dhe Financa e,

Aprovoj

Planin e punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2022; dhe i njëjti i

Rekomandohet

Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.

2. Plani i punës së Ekzekutivit të Komunës për vitin 2022;

Kryesuesi i Kuvendit: Ky është një plan më voluminoz pasi që natyra e punës së ekzekutivit është ndryshe, ku i trajtojnë më në detaje çështjet derisa të procedohen në KK, ndërkaq ne i marrim të gatshme çështjet nga ekzekutivi. Në këtë plan janë paraqitur; objektivat, synimet, qëllimet, koha dhe vendi i realizimit. Kryetari e ka trajtuar këtë plan me drejtorët, objektivat gati janë të ngjashme së vet natyra e punës është ashtu që pjesa dërmuese e aktiviteteve përsëritën. Ka veprimtari që ndryshohen dhe ka që përsëritën. Puna e drejtorive është gati e njëjtë nga viti në vit, për realizimin e kërkesave dhe nevojave të qytetarëve. Kryetari është prezent në mbledhje për me na dhënë sqarime të nevojshme. E hapi diskutimin në këtë pikë:

znj. Kadrije Lika-Troni: Unë në këtë plan pune do të ndalëm të Zyra për barazi gjinore. Vet opsioni zyrë për barazi gjinore, aty duhet të jetë një femër. Unë nuk kam asgjë personale me zyrtarin e kësaj zyre, por kisha kërkuar me intervenuar në këtë zyrë që aty më qenë një zyrtare femër. Edhe të drejtoritë, përfaqësimi me vetëm 3 femrave drejtore nuk është numër i kënaqshëm. Kërkoj që kryetari me qenë më i vëmendshëm në këtë drejtim, ashtu që me pasur me tepër femra në ekzekutiv të komunës.

Kryetari i Komunës: Përshëndetje për të gjithë, Sa i përket planit të punës së ekzekutivit, është një plan siç e tha kryesuesi që për çdo vit ia adresojmë KK. 90 % e punëve janë aktivitete të njëjta në çdo vit. Secila drejtori i ka përgjegjësitë e veta. Jemi munduar me bërë me të mirën e mundshme, nuk do të thotë së nuk ka ndonjë lëshim. Të Zyra për barazi gjinore, unë kur kam ardhur këtu e kam gjetur zyrtarin e kësaj zyre. Zyra për barazi gjinore nuk përfaqëson vetëm gjininë femërore. Kjo zyrë e ka fondin e vet, merret me aktivitete të cilat i përkasin. Nuk e di cila është arsyeja me marrë veprime të kjo zyre se duhet me pasur arsyetim për mos punë apo diç tjetër dhe me emëruar dike tjetër, sepse janë do procedura të brendshme me konkurs të brendshme që duhet përmbushen kritere për emërim. Unë nuk e kam ndonjë arsye me marrë veprime kur nuk kemi ndonjë vërejtje nga shoqëria, komuniteti apo OJQ apo gjinia femërore. Mundem me pasur parasysh kur kemi ndonjë ankesë me shqyrtuar atë ankesë, përndryshe me ligj janë të përcaktuara procedurat për çështjen e emërimeve të zyrtarëve. Me ndërruar një zyrtar, duhet me pasur njëfarë arsyetimi ose me mirëkuptim ose me ndëshkuar për me larguar prej asaj pozite. Sa i përket drejtorive, në mandatin e kaluar ka qenë një drejtor femër, tani janë emëruar tre femra. Zotimet e mia kanë qenë edhe në fushatë zgjedhore, edhe këtu shumë shpejt ka me ardhur deri të avancimi i gjinisë femërore. Mendoj së jemi në avancim të femrës për arritjen e synimeve të përbashkëta, shpresoj këto femra që janë emëruar të arrijnë rezultate.

Kryesuesi i Kuvendit : Diskutime të tjera nuk ka, atëherë a jeni që ky plan i punës të shkoj në KK për debatim ? Për votuan 5, Kundër votë nuk ka, Abstenuan 2 anëtarët nga LVV.

Në saje të kësaj del konstatimi së KPF, Planin e punës së Ekzekutivit të Komunës për vitin 2022; ia procedon Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.

Para se me kaluar në pikën 3, Kryesuesi i Kuvendit e njoftoj znj. Kadrije Lika-Troni së asambleistet e KK kanë të drejtë me themeluar grupin e grave dhe grupi i grave mund ti shtyjë përpara proceset të cilat mendoni ju.

3. Raporti i punës së Komitetit Konsultativ për Personat me Aftësi të Kufizuara, për vitin 2021;

Kryesuesi i Kuvendit: Ju të cilët nuk keni qenë anëtarë të KK, iu njoftoj së KK e ka formuar një Komitet konsultativ për persona me aftësi të kufizuara. Ky komitet i raporton KK, për këtë arsye është sjellë raporti i tyre këtu. Ai komitet fillimisht ka qenë shumë aktiv. Materialin e keni marrë, raporti shkon në KK për shqyrtim dhe aprovim. Nëse keni diçka, e hapi diskutimin:

z. Agim Mani: Komiteti konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara, me plan të punës i ka paraparë me i mbajtur 6 mbledhje për 1 vit, ndërkaq ky ka mbajtur vetëm 1 mbledhje. Arsytet thuhet së janë për shkak të situatës së Covid-19 dhe zgjedhjeve nuk janë mbajtur mbledhjet më tepër. Unë mendoj që ekzekutivi është dashur me pasur parasysh këtë çështje që së paku ky komitet me i mbajtur së paku 3 mbledhje.

znj. Ardita Rrahmani: Ne të cilët nuk kemi qenë pjesë e këtij KK, jemi të njoftuar me këtë çështje në një debat publik të organizuar. Krejt çka mendoj unë, është në përgjegjësi të KK që nuk ka arritur me i bërë presion këtij komiteti për me funksionuar për me mbajtur mbledhje me tepër. Mua me habitë mos prezenca në këtë mbledhje e Artanit-kryesues i këtij komiteti apo e Mirlinda Axhami-zëvendës kryesuese. Besoj së në kuvend do të jenë në mbledhje se kemi pyetje edhe për ta, së arsyetimi i Covid-19 dhe zgjedhjet lokale nuk është bazë për mos mbajtjen e aktiviteteve të këtij komiteti.

Kryesuesi i Kuvendit: Realisht ky është komitet dhe nuk është shumë logjike ky komitet me i raportuar komitetit, raportet e komiteteve aprovohen në KK. Besoj së në KK do të merr pjesë kryesuesi i këtij komiteti. Sa i përket presionit, ne nuk iu bëjmë presion komiteteve, ne i lëmë të lirë me funksionuar, ndërkaq KK e ka të drejtën edhe me e shpërbërë komitetet që nuk funksionojnë. Në fillim ky komitet ka qenë shumë aktiv, me çka unë jam befasuar me punën e tyre. Unë nuk e di tani pse ka ra vullneti për punë, a nuk po ua paguajnë mëditjet apo çka është në pyetje. Raporti është në KK, në KK do të merr pjesë kryesuesi i këtij komiteti dha na i sqaron për mënyrën e funksionimit të këtij komiteti.

znj. Ardita Rrahmani: Ky komitet i ka dhënë rekomandimet e tij në këtë raport, ndërkaq ekzekutivi i komunës nuk i ka zbatuar këto rekomandime.

Kryesuesi i Kuvendit: Në Kuvend diskutohen rekomandimet e këtij komiteti. Nëse nuk ka kush diçka, a jeni që ky raport t'i shkoj KK në procedurë për shqyrtim dhe aprovim. Rezultati i votimit ishte njëzëri Për. Në saje të kësaj del konstatimi së,

KPF debatoj për Raportin e punës së Komitetit Konsultativ për Personat me Aftësi të Kufizuara, për vitin 2021 dhe i njëjti i procedohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.

4. Propozim Vendimi për formimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi-KKSB;

Kryesuesi i Kuvendit: Ky këshill ka të bëjë me kryetarin e komunës i cili duhet të jetë kryesues. Miratimin e këtij këshilli e bënë KK. Kryetari besoj së i ka edhe emrat e këtij këshilli. Para se me hapur diskutimin, fjalën e ka kryetari i komunës, Besim Ilazi.

Kryetari i Komunës: Ky këshill formohet çdo legjislaturë të KK, në bazë të akterëve përfaqësues. Ky këshill i ka të përcaktuara me i mbajtur 6 mbledhje të rregullta obliguese për 1 vit. Vendimi është i njëjtë, vetëm ndryshojnë emrat e përfaqësuesve, drejtori, organizatë apo OJQ. Kryetari e përmendi përbërjen e përfaqësuesve të KKS, ndërkaq shtoj së disa pozicione nuk mund të plotësohen së komuna jonë nuk i kemi, kryesues është kryetari i komunës, nga policia e Kosovës, është komandanti i policisë. Nëse ndërrohet komandanti, ndryshimi bëhet pa shkuar çështja në KK. Nga BI është kryetari i BI të Kaçanikut. Nga Komiteti për komunitete është kryesuesi i këtij komiteti që është përzgjedhë në javën e kaluar. Zyra për barazi gjinore, drejtori i drejtorisë së arsimit, përfaqësuesi i FSK, këta e dërgojnë vet emrin, Kryetari i këshillit të prindërve në arsim,

përfaqësuesi i këshillit lokal për siguri publike, kryesuesi i ekipit lokal për siguri në bashkësi, përfaqësuesi nga emergjencat civile dhe komunale, përfaqësuesi zyrtar komunal për komunitete dhe kthim, përfaqësuesi OJQ lokale, përfaqësuesi i mediave lokale që nuk kemi, kjo mungon, përfaqësuesi i bizneseve dhe përfaqësuesve nga Handikos. Emrat janë të përcaktuar në bazë të emërimeve në dikaster apo pozicione të caktuara.

Kryesuesi i Kuvendit: Nëse ka kush diçka, e hapi diskutimin:

z. Agim Mani: A ka emra të përcaktuar të përfaqësuesve në KKSB ?

Kryetari i Komunës: Komandanti i policisë, kryetari i BI, nga OJQ është Naim Hysa -nga Kryqi i Kuq, të tjerët janë emrat që kanë qenë, e disa vijnë në bazë të pozitive.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime të tjera nuk ka, atëherë e shtoj në votim për aprovim Propozim Vendimin dhe i njëjti u aprovua me 4 votë Për, Kundër votë nuk pati, Abstenuan: Agim Mani, Kadrije Lika -Troni dhe Ardita Rrahmani. Në sajë të kësaj del konstatimi së KPF e,

Aprovoj

Propozim Vendimi për formimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi-KKSB; dhe i njëjti i,

Rekomandohet

Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.

5. Informatë e drejtorisë së Arsimit për përfundimin e periudhës të parë të Vitit shkollor, 2021/2022;

Kryesuesi i Kuvendit: Kjo është një Informatë që DA e informon KK, Kjo informatë nuk miratohet, është sa për njoftim. Drejtori nuk është këtu, nëse ka diçka, besoj se e sqaron Kryetari i Komunës.

Kryetari i Komunës: Drejtori ka pasur një intervenim dhe nuk është këtu, nëse keni diçka unë do mundohem me dhënë sqarime.

Kryesuesi i Kuvendit: Nëse nuk ka kush diçka, a jeni që kjo informatë të shkojë në procedurë të KK. Të gjithë u pajtuan njëzëri. Në sajë të kësaj del konstatimi së,

KPF diskutoj rreth Informatës së drejtorisë së Arsimit për përfundimin e periudhës të parë të Vitit shkollor, 2021/2022 dhe e njëjta i përcjellët KK në procedurë për shqyrtim.

6. Propozim Vendimi për ndarjen e masës drusore të konfiskuar në vitin 2021, shkollave të komunës;

Kryesuesi i Kuvendit: Ky propozim vendim vjen nga DBPZHR përmes kryetarit. Sasia e masës drusore të konfiskuar që grumbullohet në parkun e automjeteve, me vendim të KK i shpërndahen shkollave, sepse nëse shkojmë sipas ligjit me i shitur me ankand duhet me i shitur lirë, pastaj me i blerë për shkolla shumëfish më shtrenjtë. Ne kemi pasur telashe me drejtorin e agjencisë të pyjeve lidhur me këtë çështje, mirëpo në anën tjetër sipas LVL asetet e komunës menaxhon komuna. Ne konsiderojmë s drutë janë aset i komunës dhe mundemi me marrë një vendim ashtu si kemi marrë çdo vit. E hapi diskutimin për këtë pikë:

znj. Fitore Vishi: Unë mendoj së është vendim i duhur që masa drusore e konfiskuar t'iu ndahet shkollave të komunës.

znj. Kadrije Lika Troni : Sa është kostoja e mjeteve për dru që dedikohen për shkolla, dhe mjetet e ngelura a rialokohen për ndonjë destinim tjetër.

Kryesuesi i Kuvendit: Planifikimi për ngrohje për vitin e ardhëm. Masa drusore është e cekur në m³. Nevojat e shkollave nuk i mbulon në tërësi, por e redukton nevojën e kërkesës së prokurimit publik për dru minus këtë vlerë, për shkak së kjo masë drusore e mbulon një vlerë të asaj shume. Normalisht së kostoja e blerjes së druve ka me qenë shumë më e ulët, sa e zbutë gjendjen nuk ka ndonjë analizë.

Kryetari i Komunës: Për një vit blihen për shkolla 500 m³ dru. Ne i kemi 161 m³, ndërkaq mbeten me u blerë minus kjo shumë m³ dru. Mjetet për MSH nuk kthehen prapa, por shpenzohen për ndonjë nevojë tjetër të drejtorisë së arsimit. Ashtu siç e tha kryesuesi, nuk është bash ligjore, por nëse ne i qesim në ankand publik, i shesim 1m³ dru nga 38 euro, ndërkaq i blejmë 48 euro dhe faktikisht ne po e dëmtojmë buxhetin e komunës. Është viti i 4 apo i 5 që po marrim një vendim të tillë. Ne kemi marrë vendim një vit me ua ndarë skamnorëve, por na është kthyer i kundërligjshëm nga MAPL. Është kjo ndoshta një shkelje e vogël, por kjo po bëhet në kuptimin e ruajtjes së buxhetit.

z. Kadri Krivenjeva: Unë jam kundër ndarjen e masës drusore, institucioneve shkollore. Arsyeja, sepse institucionet e kanë buxhetin, i kanë mjetet për secilin destinacion. Unë kam propozim që këto dru t'iu shpërndahen familjeve skamnore, duke ditur gjendjen e tyre, duke ditur së në komunën tonë kemi familje në varfëri në ekstrem. Duke marrë përbuzë temperaturat minus në këtë kohë, unë jam t'iu ndahen familjeve skamnore, unë e shoh me të arsyeshme që drutë e konfiskuara t'iu ndahen familjeve skamnore.

Kryetari i Komunës: Nëse merret ky vendim, kemi me të caktuar anëtar të komisionit me i ndarë drutë. Nëse drutë e konfiskuara ua ndajmë skamnorëve, me shumë krijojmë probleme sesa bëjmë zgjidhje, se nuk mundesh me ua ndarë asnjë familje me tepër së 1 m dru. Në këtë kuptim vetëm sa e vështirësojmë situatën, se për ka 1m dru me tepër na shajnë sesa na lavdërojnë, kjo është arsyeja pse nuk ua ndajmë skamnorëve këto dru.

z. Kadri Krivenjeva: Për mua me mirë është më ia ndarë një krah dru dikujt sesa shkollave, se në fund të fundit është obligim i ynë me iu ndihmuar qytetarëve të komunës që janë në nevojë.

Kryetari i Komunës: Mbi 800 familje i kemi me asistencë sociale. Jemi duke kursyer para për ata që kanë e nuk jemi duke dhënë dru atyre që kanë nevojë, ky është mendimi im.

Kryesuesi i Kuvendit: Ne kemi marrë një vendim parvjet dhe ai vendim na është kthyer nga MAPL i kundërligjshëm. Pastaj është marr vendim me ua ndarë drutë shkollave, MAPL nuk na ka kthyer konfirmim hiq, d. m. th. e ka heshtur vendimin. Sipas ligjit për pyjet, masa drusore që konfiskohet, shitet ma ankand publik, ku 70 % i merr agjencia, ndërkaq 30 % komuna, ndërsa në anën tjetër LVL thotë se komuna ka të drejtë që t'i përdorë asetet e veta sipas nevojave që ka., kjo e mbulon atë dhe e kemi shfrytëzuar këtë të drejtë. Nëse vendimin nuk na i kthen MAPL duhet me ekzekutuar.

z. Kadri Krivenjeva: Ne kemi familje që janë pa përkrahje pa mbështetje, si pleqtë etj. që nuk kanë mundësi me blerë dru, ka plotë familje.

z. Agim Mani: Nëse drutë iu ndahen shkollave të komunës, atëherë mjetet e ngelura nga buxheti të parapara për atë destinim është mirë me iu ndarë fëmijëve nga familjet skamnore.

znj. Ardita Rrahmani: Sa është sasia e druve që iu ndahen shkollave ?

Kryetari i Komunës: Sasia e druve që iu ndahen shkollave janë diku, **161m3**.

z. Sabedin Vishi-Nënkryetar i Komunës: Së pari iu përshëndes të gjithëve, iu uroj marrjen e mandatit. Sa i përket ndarjes së masës drusore, edhe unë jam me ua ndarë skamnorëve, por mos po krijojmë përçarje, ndërkaq nëse drutë ua ndajmë shkolla të komunës, atëherë koston e mjeteve buxhetore mund të shfrytëzohen për pagesën e mujorëve për nxënës skamnor, apo për ndonjë nevojë tjetër të nxënësve.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime të tjera nuk ka, atëherë a jeni që ky propozim t'i shkoj KK. Njëzëri u pajtuan të gjithë. Në sajë të kësaj del konstatimi së KPF e,

Aprovoj

Propozim Vendimi për ndarjen e masës drusore të konfiskuar në vitin 2021, shkollave të komunës; dhe i njëjti i,

Rekomandohet

Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.

7. Kërkesa e Asociacionit të Komunave të Kosovës- AKK, për emërimin e delegatëve në Kuvendin e AKK;

Kryesuesi i Kuvendit: Nga Asociacioni i Komunave të Kosovës na ka ardhur një kërkesë për caktimin e përfaqësuesve nga kuvendi i komunës në asociacion. Kjo çështje ka të bëjë me KK, megjithatë do të trajtojmë si pikë. Nëse ka kush diçka e hapi diskutimin:

z. Agim Mani: Sa është numri i anëtarëve nga komuna jonë që duhet caktuar në AKK.

Kryesuesi i Kuvendit: Numri i anëtarëve që duhet caktuar është 2 apo 3. Në 10 anëtarë të KK duhet të jetë 1 anëtarë. Nëse nuk ka diskutime, a jeni që kjo kërkesë t'i adresohet KK. Njëzëri u pajtuan të gjithë. Në sajë të kësaj del konstatimi së,

KPF e shqyrtoj Kërkesën e Asociacionit të Komunave të Kosovës- AKK, për emërimin e delegatëve në Kuvendin e AKK dhe e njëjta i adresohet KK për shqyrtim dhe aprovim.

Diçka tjetër për këtë takim nuk ka, kështu e konstatoj mbledhjen e përfunduar në ora: 11:53. Deri në fund të mbledhjes qëndruan të gjithë anëtarët e KPF.

Mbledhja e Kuvendit do të mbahet me 28 Janar 2022 në ora 11:00.

Procesmbajtës
Makfire Malsiu
M Malsiu

